



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 16

Tiranë – E hënë, 23 qershor 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Njoftim i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 8071, datë 17.6.2025	Për shitje me ankand të pronës shtetërore në administrim të Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë, Tiranë..... 3
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nr. 2469, datë 25.4.2025	Për mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “BELLE AIR” sh.p.k..... 3
Kërkesë e Ministrisë së Drejtësisë nr. 3134/1, datë 20.6.2025	Për shpallje për shprehje interesi për kandidatët që kërkojnë të certifikohen si ndërmjetës të pasurive të paluajtshme..... 5



NJOFTIM

Nr. 8071, datë 17.6.2025

**PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS
SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË
INSTITUTIT TË PËRGATITJES SË
QENVE TË POLICISË, TIRANË**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, kapitulli III, shpallen për shitje me çmim fillestar, si më poshtë:

1. Në administrim të Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë, Tiranë

Nr.	Emërtimi	Datëlindja	Vendndodhja	Vlera fillestare e ankandit në lekë	Zhvillimi i ankandit		
					Data	Ora	Vendi
1	Qeni Korba	11.11.2014	Tiranë	10,000	15.7.2025	10:00	DSHPP
2	Qeni Def	28.6.2016	Tiranë	10,000	15.7.2025	10:15	DSHPP
3	Qeni Kofi	3.10.2013	Tiranë	10,000	15.7.2025	10:30	DSHPP
4	Qeni Drago	6.1.2016	Tiranë	10,000	15.7.2025	10:45	DSHPP
5	Qeni Blu	30.4.2023	Tiranë	10,000	15.7.2025	11:00	DSHPP
6	Qeni Neo	30.4.2023	Tiranë	10,000	15.7.2025	11:15	DSHPP
7	Qeni Nili	5.8.2023	Tiranë	10,000	15.7.2025	11:30	DSHPP
8	Qeni Aja	24.9.2023	Tiranë	10,000	15.7.2025	11:45	DSHPP

Çdo person fizik apo juridik, i interesuar për blerje, duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerje e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

2. Garancinë bankare apo mandatpagesën në origjinal, që vërteton ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë, për llogari të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e shpallur për shitje, i konfiskohet 20% e garancisë bankare, e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Garancia bankare apo mandatpagesa duhet të bëhet detyrimsht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Garancia bankare apo mandatpagesa mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, pasi të keni tërhequr pranë DSHPP-së,

ose degëve të thesarit në rrethe, faturën për arkëtim, të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

VENDIM

Nr. 2469, datë 25.4.2025

**PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË
FALIMENTIMIT TË SHOQËRISË
“BELLE AIR” SHPK**

SHKURTIM VENDIMI

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e përbërë nga:

GJYQTAR: Ervin Pollozhani,

asistuar nga sekretare gjyqësore Silvana Marku, sot, më datë 25.4.2025, shqyrtoi në seancë gjyqësore publike, çështjen civile-tregtare, me nr. 10332/1267/379/235/171/140/126/119/102/97/92/83 regj. themeltar, që i përket:

KËRKUESE: Shoqëria “BELLE AIR” sh.p.k., me NIPT K51817001T, me seli në adresën: rruga “Jordan Misja”, pallati “Sara-El”,



shkalla 1, apartamenti 1, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga znj. Shpresa Breçani, me cilësinë e administratores së falimentimit të shoqërisë “BELLE AIR” sh.p.k.

OBJEKTI: Mbyllje e procedurës së falimentimit të shoqërisë “BELLE AIR” sh.p.k., me NIPT K51817001T, me seli në adresën: rruga “Jordan Misja”, pallati “Sara-El”, shkalla 1, apartamenti 1, Tiranë, Shqipëri.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar; neni 163 i tij.

Gjykata, pasi administroi provat shkresore, dëgjoi administratoren e falimentit znj. Shpresa Breçani, e cila u shpreh për përfundimin e procedurës së falimentimit, për shkak të likuidimit të të gjitha pasurive të debitorit dhe shpërndarjen e të ardhurave të kreditorët e falimentit, anëtarët e Komitetit të Kreditorëve, që ishin dakord me mbylljen e kësaj procedure, ndërsa anëtari i Komitetit të Kreditorëve, si përfaqësues i aeroporteve, z. Ervin Bano, ishte dakord me mbylljen e procedurës, porse e la në çmim të gjykatës çregjistrimin e shoqërisë, si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në përfundim të saj,

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë debitorë “BELLE AIR” sh.p.k. me NIPT K51817001T, me seli në adresën: rruga “Jordan Misja”, pallati “Sara-El”, shkalla 1, apartamenti 1, Tiranë, Shqipëri, me objekt të veprimtarisë së saj në fushën e transportit ndërkombëtar të personave, mallrave, postës, me çdo lloj mjeti transporti ajror, për shkak të likuidimit të të gjithë pasurisë së saj dhe shpërndarjes së të ardhurave, duke e shpallur si shoqëri e falimentuar.

2. Urdhërohet çregjistrimi i shoqërisë “BELLE AIR” sh.p.k. nga regjistri tregtar i shoqërive pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

3. Urdhërohet çregjistrimi i shoqërisë “BELLE AIR” sh.p.k. nga organet tatimore, si dhe nga të gjitha organet apo institucionet në të cilat është e regjistruar.

4. Urdhërohet publikimi i vendimit për mbylljen e procedurave të falimentimit të debitorit, shoqërisë “BELLE AIR” sh.p.k., në Buletin Zyrtar të Njoftimeve Publike.

5. Urdhërohet publikimi i këtij vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në adresën zyrtare në internet të këtij institucioni, në adresën zyrtare në internet të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

6. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “BELLE AIR” sh.p.k. t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Biznesit.

7. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “BELLE AIR” sh.p.k. t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

8. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “BELLE AIR” sh.p.k. t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, si dhe Degës së Doganës Tiranë.

9. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit të debitorit, shoqërisë “BELLE AIR” sh.p.k., bashkë me raportin përfundimtar të administratores së falimentimit Shpresa Breçani, t’i komunikohet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për verifikimin e konsumimit të veprave penale në fushën e shoqërive tregtare dhe të falimentimit.

10. Shpenzimet gjyqësore sipas ligjit për falimentimin.

11. Kundër vendimit lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 5 ditëve, afat ky që fillon sipas ligjit.

12. U shpall sot, më datë 25.4.2025, në Tiranë, ora 14:55.

SEKRETARE
Silvana Marku

GJYQTAR
Ervin Pollozhani

Shënim. Vendimi mori formë të prerë pasi nuk u ankimua më datë 9.6.2025.

Tiranë, më datë 11.6.2025.

**KËRKESË****Nr. 3134/1, datë 20.6.2025****PËR SHPALLJE PËR SHPREHJE
INTERESI PËR KANDIDATËT QË
KËRKOJNË TË CERTIFIKOHEN SI
NDËRMJETËS TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME**

Në ligjin nr. 9/2022, “Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme”, dhe urdhrin nr. 187, datë 4.5.2022, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme mbi paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të personave që kërkojnë të certifikohen si ndërmjetës të pasurive të paluajtshme”, janë përcaktuar rregullat për paraqitjen, trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të personave që kërkojnë të certifikohen si ndërmjetës të pasurive të paluajtshme. Kandidati për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme paraqet shprehjen e interesit dhe dokumentacionin shoqërues, brenda 15 ditëve nga përfundimi i afatit të publikimit. Kandidati për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme, që kërkon të certifikohet si ndërmjetës i pasurive të paluajtshme, depoziton pranë Ministrisë së Drejtësisë, përmes shërbimit postar ose dorazi, dokumentacionin bashkangjitur:

1. Kërkesë për shprehje interesi për certifikimin si ndërmjetës i pasurive të paluajtshme;
2. Kopje të mjetit të identifikimit;
3. Certifikatë familjare;
4. Kopje të njësuar të diplomës së arsimit të mesëm të lartë, të lëshuar nga një institucion arsimor i akredituar në Republikën e Shqipërisë, ose diplomë

të lëshuar nga një institucion arsimor i huaj, të njohur e të njësuar nga ministria përgjegjëse për arsimin;

5. Vërtetim nga prokuroria që nuk është nën hetim për veprat penale në fushën e pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit, apo të armëve të shkatërrimit në masë;

6. Vërtetim nga gjykata që nuk është nën gjykim për veprat penale në fushën e pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit, apo të armëve të shkatërrimit në masë;

7. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore të kandidatit dhe për personat e lidhur me të;

8. Vetëdeklarim që nuk ka dënim me masë administrative gjobë ose masë administrative që detyron subjektin të ndalë një sjellje të caktuar, praktikë pune apo biznesi, si dhe të mos e përsërisë në të ardhmen, për shkelje të legjislacionit në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave, të paktën jo më herët se 6 muaj nga data e paraqitjes së kërkesës;

9. Certifikatë për përfundimin me sukses të programit të detyrueshëm të trajnimit për kandidatët për ndërmjetës të pasurive të paluajtshme;

10. Dokument që provon zotërimin e gjuhës shqipe, të lëshuar nga autoritetet kompetente sipas legjislacionit në fuqi (për shtetasin e huaj).

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2025

